01-143

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo **Komuna e Prishtinës** Opština Priština – Municipality of Prishtina	PRISHTINA

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22, 44 dhe 84 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, dt.21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt. 20.02.2008 dhe nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 nr. 350 /03 - 23549/20 dt.29.01.2020, të kërkuesve: Bashkëpronarëve, Kujtim Vokrri dhe Bajram Elezkurtaj nga Prishtina, Pronarëve Shaip dhe Naser Zeka, Përparim dhe Lulzim Dulatahu, Blerta Lleshi Dulatahu dhe Investitorit "BP Construction"sh.p.k. nga Prishtina, rr."Uran Ajeti",BL.-C-16,H-1A,Lok.3-4, me certifikatë të regjistrimit të biznesit 810052887, përfaqësuar nga Bashkim Hasani, për miratimin e ndryshimit, plotësimit dhe zgjerimit të Vendimit të kushteve ndërtimore 05nr.350/02– 0259372/18 dt.11.12.2018, pranimin e palëve në procedurë dhe përfshirje në "zgjidhje urbane" dhe ndërtim, kushte ndërtimore këto për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e ***Kompleksi "Ylli"*** me ndërtesë shumë banesore & afariste – Objekti, "A", "B", "C" & "G", në kuadër të Bllokut urban "C-4", të Planit Rregullues "Kalabria" dhe PZHU-së në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative për vendosjen e çështjes administrative, me datë 12.02.2020 merr këtë:

V E N D I M

I MIRATIMIT TË KËRKESËS PËR NDRYSHIMIN,PLOTËSIMIN DHE ZGJERIMIN E VENDIMIT TË KUSHTEVE NDËRTIMORE 05NR.350/02 – 0259372/18 DT.11.12.2018 DHE PRANIMIN E PALËVE NË PROCEDURË

I. Miratohet kërkesa 05 nr. 350 /03 - 23549/20 dt.29.01.2020 e kërkuesve: Bashkëpronarëve, Kujtim Vokrri dhe Bajram Elezkurtaj nga Prishtina, Pronarëve Shaip dhe Naser Zeka, Përparim dhe Lulzim Dulatahu, Blerta Lleshi Dulatahu dhe Investitorit "BP Construction"sh.p.k. nga Prishtina, rr. "Uran Ajeti", BL.-C-16,H-1A,Lok.3-4, me certifikatë të regjistrimit të biznesit 810052887, përfaqësuar nga Bashkim Hasani, për ndryshimin, plotësimin dhe zgjerimin e Vendimit të Kushteve ndërtimore 05nr.350/02 – 0259372/18 dt.11.12.2018, pranimin e palëve në procedurë dhe përfshirje në "zgjidhje urbane" dhe ndërtim, duke trajtuar përmes transferimit edhe pjesët e parcelave kadastrale nr.1840-5 dhe 1873-9 ZK Prishtinë;

II. Ndryshohet, plotësohet dhe zgjerohet Vendimi i kushtet ndërtimore 05nr.350/02 – 0259372/18 dt.11.12.2018, të caktuara nga kjo drejtori, në emër të kërkuesve/ Bashkëpronareve, Kujtim Vokrri dhe Bajram Elezkurtaj nga Prishtina dhe Investitorit "BP Constriction"sh.p.k. nga Prishtina, rr. "Uran Ajeti",BL.-C-16,H-1A,Lok.3-4, me certifikatë të regjistrimit të biznesit 810052887 përfaqësuar nga Bashkim Hasani, sipas kërkesës për kushte ndërtimore, 05nr.350 /02 - 0259372/18 dt.26.10.2018, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e ***Kompleksi "Ylli"*** me ndërtesa shumë banesore & afariste - Objekti "A", "B", "C" & "G", në kuadër të parcelës ndërtimore të Blloku urban "C-4" të Planit Rregullues "Kalabria" & PZHU-së në Prishtinë, gjegjësisht parcelës kadastrale, nr.1871-0 ZK Prishtinë, si dhe pranohen palët në procedurë, përfshirje në "zgjidhje urbane" dhe ndërtim, duke trajtuar përmes transferimit edhe pjesët e parcelave kadastrale nr.1840-5 dhe 1873-9 ZK Prishtinë;

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

Ndryshimi, plotësimi dhe zgjerimi i Vendimit të kushteve ndërtimore 05nr.350/02 – 0259372/18 dt.11.12.2018, nga paragrafi II. i këtij vendimi do të bëhet në: preambulë, dispozitiv, arsyetim dhe pjesën grafike – "zgjidhje urbane" si në vijim:

- **Pjesa e preambulës nga**:

Në bazë të kërkesës 05 nr. 350 /02 - 0259372/18 dt.26.10.2018 të bashkëpronarëve, Kujtim Vokrri dhe Bajram Elezkurtaj nga Prishtina, dhe Investitorit "BP Constriction"sh.p.k. nga Prishtina, rr."Uran Ajeti",BL.-C-16,H-1A,Lok.3-4, me certifikatë të regjistrimit të biznesit 810052887, përfaqësuar nga Bashkim Hasani, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e ***Kompleksi "Ylli"*** *me ndërtesë shumë banesore & afariste – Objekti "A", "B", "C" & "G", në kuadër të Bllokut urban "C-4", të Planit Rregullues "Kalabria" dhe PZHU-së në Prishtinë;*

- **Bëhet**:

Në bazë të kërkesave, 05 nr. 350 /02 - 0259372/18 dt.26.10.2018 dhe 05 nr. 350 /03 - 23549/20 dt.29.01.2020, të Bashkëpronarëve, Kujtim Vokrri dhe Bajram Elezkurtaj nga Prishtina, Pronarëve Shaip dhe Naser Zeka, Përparim dhe Lulzim Dulatahu, Blerta Lleshi Dulatahu nga Prishtina dhe Investitorit "BP Constriction"sh.p.k. nga Prishtina, rr."Uran Ajeti",BL.-C-16,H-1A,Lok.3-4, me certifikatë të regjistrimit të biznesit 810052887, përfaqësuar nga Bashkim Hasani, për miratimin e kërkesës dhe caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e ***Kompleksi "Ylli"*** me ndërtesë shumë banesore & afariste – Objekti "A", "B", "C" & "G", në kuadër të Bllokut urban "C-4", të Planit Rregullues "Kalabria" dhe PZHU-së në Prishtinë;

- **Paragrafi I. i dispozitivit nga**:

I caktohen kushtet ndërtimore bashkëpronarëve, Kujtim Vokrri dhe Bajram Elezkurtaj nga Prishtina dhe Investitorit "BP Constriction"sh.p.k. nga Prishtina, rr. "Uran Ajeti",BL.-C-16,H-1A,Lok.3-4, me certifikatë të regjistrimit të biznesit 810052887 përfaqësuar nga Bashkim Hasani, sipas kërkesës për kushte ndërtimore, 05nr.350 /02 - 0259372/18 dt.26.10.2018, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e ***Kompleksi "Ylli"*** *me ndërtesa shumë banesore & afariste - Objekti "A", "B", "C" & "G", në kuadër të parcelës ndërtimore të Blloku urban "C-4" të Planit Rregullues "Kalabria" & PZHU-së në Prishtinë, gjegjësisht parcelës kadastrale, nr.1871-0 ZK Prishtinë.*

- **Bëhet**:

I caktohen kushtet ndërtimore, Bashkëpronarëve, Kujtim Vokrri dhe Bajram Elezkurtaj nga Prishtina, Pronarëve, Shaip dhe Naser Zeka, Përparim dhe Lulzim Dulatahu, Blerta Lleshi Dulatahu nga Prishtina dhe Investitorit "BP Constriction"sh.p.k. nga Prishtina, rr. "Uran Ajeti",BL.-C-16,H-1A, Lok.3-4, me certifikatë të regjistrimit të biznesit 810052887 përfaqësuar nga Bashkim Hasani, sipas kërkesave për kushte ndërtimore, 05nr.350 /02 - 0259372/18 dt.26.10.2018 dhe kërkesës 05 nr. 350 /03 - 23549/20 dt.29.01.2020 për ndryshimin, plotësimin dhe zgjerimin e kushteve ndërtimore, kushte ndërtimore këto për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e ***Kompleksi "Ylli"*** me ndërtesa shumë banesore & afariste - Objekti "A", "B", "C" & "G", në kuadër të parcelës ndërtimore të Blloku urban "C-4" të Planit Rregullues "Kalabria" & PZHU-së në Prishtinë, gjegjësisht parcelës kadastrale, nr.1871-0 ZK Prishtinë, me trajtim përmes transferimit edhe të pjesëve të parcelave kadastrale nr.1840-5 dhe 1873-9 ZK Prishtinë;

- **Pika 1, 2 dhe 3 e paragrafi III. të dispozitivit nga**:

- *Numri, sipërfaqja, pronari & klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë:*
  - nr.1871-0; S=5186m²; Kujtim Vokrri dhe Bajram Elezkurtaj; "Arë e klasit 4";
- *E drejta pronësore-juridike e parcelës nr.1871-0 ZK Prishtinë, është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;*
- *Në kuadër të parcelës, nr.1871-0 ZK Prishtinë, nuk ka ndërtesa të ndërtuara ;*

- **Bëhet**:

- Numri, sipërfaqja, pronari & klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë:
  - nr.1871-0; S=5186m²; Kujtim Vokrri dhe Bajram Elezkurtaj; "Arë e klasit 4";
  - nr.1840-5; S=934m²; Përparim, Lulzim Dulatahu, Blerta Lleshi Dulatahu; "Kullosë e klasit 3";
  - nr.1873-9; S=3586m²; Naser dhe Shaip Zeka; "Arë e Klasit 5";

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

Totali: S= 9706m²

- E drejta pronësore-juridike e parcelës nr.1871-0 (tani nr.1871-1), 1840-5 dhe 1873-9 ZK Prishtinë, është private, në bazë të kopjeve të planit dhe certifikatave të njësisë kadastrale;
- *Në kuadër të parcelës, nr.1871-0* (tani nr.1871-1) *dhe nr.1840-5 ZK Prishtinë, nuk ka ndërtesa të ndërtuara, kurse në kuadër të parcelës nr.1873-9 ZK Prishtinë janë tri ndërtesa individuale banimore me etazhitet S+P;*

- **Pika 5 e paragrafi IV. të dispozitivit nga**:

- *Me këto kushte ndërtimore në kuadër të Kompleksit "Ylli", planifikohet ndërtesa shumë banesore & afariste, me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet (sipas projekt propozimit), si në vijim:*
  Kompleksi "Ylli" me ndërtesa shumë banesor & afariste – Objekti "A", "B", "C" & "G"
  ***Objekti "A" - S=6053.08m²**, / 4628.48m², mbi tokë + 1424.60m², nën tokë /;*
  *Etazhitet: **B + 2S + P + 6**;*
  ***Objekti "B" - S=920m²**, / 460m², mbi tokë + 460m², nën tokë/;*
  *Etazhitet: **B + 2S + P + 0**;*
  ***Objekti "C" - S=6044.50m²**, / 4245.75m², mbi tokë + 1798.75m², nën tokë/;*
  *Etazhitet: **2B + S + P + 6**;*
  ***Objekti "G" - S=1777.6m²**, / 0.00m², mbi tokë +1777.60m², nën tokë/;*
  *Etazhitet: **-2B** .*
  ***Totali i sipërfaqeve ndërtimore**, **S=14795.18m²** / 9334.23m², mbi tokë + 5460.95m², nën tokë/*

- **Bëhet** :

- *Me këto kushte ndërtimore në kuadër të **Kompleksit "Ylli"**, planifikohet ndërtesa shumë banesore & afariste, me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet (sipas projekt propozimit), si në vijim:*
  Kompleksi "Ylli" me ndërtesa shumë banesor & afariste – Objekti "A", "B", "C" & "G"
  ***Objekti "A" - S=6527.50m²**, / 5091.70m², mbi tokë + 1435.80m², nën tokë /;*
  *Etazhitet: **B + 2S + P + 7**;*
  ***Objekti "B" - S=919.60m²**, / 459.80m², mbi tokë + 459.80m², nën tokë/;*
  *Etazhitet: **B + 2S + P + 0**;*
  ***Objekti "C" - S=5824m²**, / 4390.80m², mbi tokë + 1433.20m², nën tokë/;*
  *Etazhitet: **B + S + P + 8**;*
  ***Objekti "G" - S=1802.40m²**, / 0.00m², mbi tokë + 1802.40m², nën tokë/;*
  *Etazhitet: **-2B** .*
  ***Totali i sipërfaqeve ndërtimore**, **S=15073.10m² / 9942.30m²**, mbi tokë + **5131.20m²**, nën tokë/*

- **Pika 11 e paragrafi IV. të dispozitivit nga**:

- *Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas planit rregullues për pjesën afariste është 2.8 kurse pjesën banimore është 1.6. Sipas PZHU-së, ky koeficient është 1.8 ÷ 3.0. Sipas Projekt propozimit – "zgjidhja urbane" dhe i miratuar, është 1.8, gjegjësisht koeficienti minimal i PZHU-së.*
  *Trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ±0.00, 50% për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - **suteren**, dhe **0%** për etazhet e nëntokës – **bodrum**, dhe kjo sipërfaqe është:*
  S=3777 x 1.8=6798.60m²; /lejuar sipas PZHU-së për banim & afarizëm/,
  S=9334.20m²; /sipas projekt propozimit dhe miratuar duke llogaritur edhe shpronsimi /

- **Bëhet**:

- *Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas planit rregullues për pjesën afariste është 2.8 kurse pjesën banimore është 1.6. Sipas PZHU-së, ky koeficient është 1.8 ÷ 3.0. Sipas Projekt propozimit – "zgjidhja urbane" dhe i miratuar, është 1.8, gjegjësisht koeficienti minimal i PZHU-së.*
  *Trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ±0.00, 50% për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - **suteren**, dhe **0%** për etazhet e nëntokës – **bodrum**, dhe kjo sipërfaqe është:*
  S=3777 x 1.8=6798.60m²; /lejuar sipas PZHU-së për banim & afarizëm/,
  S=9942.30m²; /sipas projekt propozimit duke llogaritur edhe shpronësimi /

- **Pika 12 e paragrafi IV. të dispozitivit nga**:

- *Me aplikimin e Vendimit 01nr.031–185483 dt.14.08.2015 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, konkretisht bazuar në paragrafin I. të vendimit, për aplikimin e sipërfaqes së përgjithshme, të*

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

*përvetësohet koeficienti minimal i PZHU-së për kompensimin e pronës private për interes publik me sipërfaqe ndërtimore, ku sipërfaqja jashtë vijës rregulluese e parcelës nr.1871-0 ZK Prishtinë S=1387.34+11.45+10.21=1409m², trajtuar në kompleks përmes transferimit, mund të kompensohet me sipërfaqe ndërtimore, dhe sipas kësaj, sipërfaqja e parcelës kadastrale do të kompensohet me sipërfaqe ndërtimore prej S= 1409 x 1.8=**2536.20m².***

*Andaj sipërfaqja totale e lejuar ndërtimore e Kompleksit "Ylli" me ndërtesë shumë banesore & afariste - Objekti "A", "B", "C" & "G", është, **S=6798.60 + 2536.20=9334.80m²;***

- **Bëhet**:

- *Me aplikimin e Vendimit 01nr.031–185483 dt.14.08.2015 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, konkretisht bazuar në paragrafin I. të vendimit, për aplikimin e sipërfaqes së përgjithshme, të përvetësohet koeficienti minimal i PZHU-së për kompensimin e pronës private për interes publik me sipërfaqe ndërtimore, ku sipërfaqja jashtë vijës rregulluese e parcelës nr.1871-0 ZK Prishtinë S=1387.34+11.45+10.21=1409m², parcelës kadastrale nr.1840-5 me S=129m² dhe parcelës kadastrale nr.1873-9 me S=209m², të trajtuar në kompleks përmes transferimit, mund të kompensohet me sipërfaqe ndërtimore, dhe sipas kësaj, sipërfaqja e parcelës kadastrale do të kompensohet me sipërfaqe ndërtimore prej S= (1409 + 129 + 209) x 1.8=3144.60m².*

*Andaj sipërfaqja totale e lejuar ndërtimore e Kompleksit "Ylli" me ndërtesë shumë banesore & afariste - Objekti "A", "B", "C" & "G", do të jetë: **S=6798.60 + 3144.60=9943.20m²;***

- **Paragrafi V. i dispozitivit nga:**

Kompensimi / shpronësimi me sipërfaqe ndërtimore i pjesës së parcelës, nr.1871-0 ZK Prishtinë me S=1409m², e përfshirë në hapësira publike të planifikuar – Rrugë & hapësira publike, të realizohet si më poshtë:

Me aplikimin e Vendimit 01nr.031 – 185483 dt.14.08.2015 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, konkretisht paragrafit I. për aplikimin e sipërfaqes së përgjithshme, të përvetësohet koeficienti minimal i PZHU-së që është 1.8, për kompensimin e pronës private për interes publik me sipërfaqe ndërtimore, ku sipërfaqja jashtë vijës rregulluese e kësaj parcele është S=1387.34 + 11.45 + 10.21=1409m²,për trajtim në kompleks, dhe e njëjta mund të kompensohet me sipërfaqe ndërtimore, dhe sipas kalkulimit kjo sipërfaqe e parcelës, do të kompensohet me sipërfaqe ndërtimore S= 1409 x 1.8=2536.20m².

Drejtoria jep PËLQIM për kompensimin / shpronësimin me sipërfaqe ndërtimore të pjesës së parcelës nr.1871-0 ZK Prishtinë, bazuar në vendimin e lartcekur. Procedura e kompensimit / shpronësimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, dhe i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të bashkëpronarëve dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës të Komunës së Prishtinës.

Sipërfaqja definitive e kompensimit / shpronësimit të trajtohet pas ndarjes së parcelës sipas paragrafit VI. të këtij vendimi.

Mos zbatimi i kësaj procedure nga bashkëpronarët, për arsye të ndryshme, obligon *Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesës shumë banesore & afariste, të përcaktuara me këtë vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore.*

- **Bëhet**:

Kompensimi / shpronësimi me sipërfaqe ndërtimore i pjesës së parcelës, nr.1871-0 ZK Prishtinë me S=1409m², dhe pjesëve të parcelave nr.1840-5 me S=129m² dhe nr.1873-9 me S=209m², e përfshirë në hapësira publike të planifikuar – Rrugë & hapësira publike, të realizohet si më poshtë:

Me aplikimin e Vendimit 01nr.031 – 185483 dt.14.08.2015 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, konkretisht paragrafit I. për aplikimin e sipërfaqes së përgjithshme, të përvetësohet koeficienti minimal i PZHU-së që është 1.8, për kompensimin e pronës private për interes publik me sipërfaqe ndërtimore, ku sipërfaqja jashtë vijës rregulluese e kësaj parcele është S=1387.34 + 11.45+10.21+129+209=1409+338=1747m²,për trajtim në kompleks, dhe e njëjta mund të kompensohet me sipërfaqe ndërtimore, dhe sipas kalkulimit kjo sipërfaqe e parcelës, do të kompensohet me sipërfaqe ndërtimore S=(1409+338) x 1.8=3144.60m².

Drejtoria jep PËLQIM për kompensimin / shpronësimin me sipërfaqe ndërtimore të pjesës së parcelës nr.1871-0, 1840-5 & 1873-9 ZK Prishtinë, bazuar në vendimin e lartcekur. Procedura e

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

kompensimit / shpronësimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, dhe i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të bashkëpronarëve dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës të Komunës së Prishtinës.
Sipërfaqja definitive e kompensimit / shpronësimit të trajtohet pas ndarjes së parcelës sipas paragrafit V. /Ndarja/ të vendimit.
Mos zbatimi i kësaj procedure nga bashkëpronarët, për arsye të ndryshme, obligon *Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesës shumë banesore & afariste, të përcaktuara me vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore.*

- **Paragrafi V. i dispozitivit nga:**

Ndarja/parcelimi i parcelës, nr.1871-0, ZK Prishtinë, do të realizohet sipas parcelës ndërtimore, të përcaktuar me vijën rregulluese të planit rregullues urban, bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dispozitës urbanistike dhe Manualit për ndarje.

Drejtoria jep PËLQIM për ndarjen e parcelës së lartcekur, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane", *"Situacioni i parcelës me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01",* punuar nga kjo drejtori dhe Manuali i ndarjes, punuar nga kompania gjeodezike "Geo-Group"sh.p.k nga Prishtina. Procedura e ndarjes / parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtij ndryshimi.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarit, duke u bazuar në, Plani i situacionit - "zgjidhja urbane", *"Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01"*, punuar nga kjo drejtori dhe Manualit për ndarje, punuar nga Kompania gjeodezike e licencuar "Geo-Group"sh.p.k nga Prishtina me licencë nr.52, e i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

- **Bëhet**:

Ndarja/parcelimi i parcelës, nr.1871-0, 1840-5 & 1873-9 ZK Prishtinë, do të realizohet sipas parcelës ndërtimore, të përcaktuar me vijën rregulluese të planit rregullues urban, bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dispozitës urbanistike dhe Manualit për ndarje.

Drejtoria jep PËLQIM për ndarjen e parcelës së lartcekur, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane", *"Situacioni i parcelës me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01",* punuar nga kjo drejtori dhe Manuali i ndarjes, punuar nga kompania gjeodezike "Geo-Group"sh.p.k nga Prishtina dhe gjeodeti i licencuar Ferid Nj.Ahmeti . Procedura e ndarjes / parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtij ndryshimi.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarit, duke u bazuar në, Plani i situacionit - "zgjidhja urbane", *"Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01"*, punuar nga kjo drejtori dhe Manualit për ndarje, punuar nga Kompania gjeodezike e licencuar "Geo-Group"sh.p.k nga Prishtina me licencë nr.52, dhe gjeodeti i licencuar Ferid Nj.Ahmeti me licencë nr.174, e të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore

III. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe Plani i situacionit -"zgjidha urbane" e kompleksit me ndërtesa të planifikuara dhe hapësirat përcjellëse dhe Manuali i ndarjes së parcelave kadastrale nr.1840-5 dhe 1873-9 ZK Prishtinë, punuar nga gjeometri i licencuar;

IV. Ky vendimi do të jetë pjesë përbërëse e Vendimit të kushteve ndërtimore 05nr.350/02 – 0259372/18 dt.11.12.2018, dhe i njëjti do të prodhojë efekt juridik nga dita e miratimit të tij.

A r s y e t i m

Kërkuesit / Bashkëpronarët, Kujtim Vokrri dhe Bajram Elezkurtaj nga Prishtina, Pronarët, Shaip dhe Naser Zeka, Përparim dhe Lulzim Dulatahu, Blerta Lleshi Dulatahu dhe Investitorit "BP Construction"sh.p.k. nga Prishtina, rr."Uran Ajeti",BL.-C-16,H-1A,Lok.3-4, me certifikatë të

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

regjistrimit të biznesit 810052887, përfaqësuar nga Bashkim Hasani, me kërkesën 05 nr. 350 /03 - 23549/20 dt.29.01.2020, kanë kërkuar nga kjo drejtori miratimin e kërkesës për ndryshimin, plotësimin dhe zgjerimin e Vendimit të kushteve ndërtimore 05nr.350/02– 0259372/18 dt.11.12.2018, dhe pranimin e palëve në procedurë / përfshirje në "zgjidhje urbane" dhe në ndërtim, kushte këto për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e ***Kompleksi "Ylli"*** me ndërtesë shumë banesore & afariste – Objekti "A", "B", "C" & "G", në lokacionin e përshkruar në paragrafin II. të këtij vendimi.

Me kërkesën për miratimin e ndryshimit, plotësimit dhe zgjerimin të kushte ndërtimore, 05 nr. 350 /03 - 23549/20 dt.29.01.2020 dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës, është prezantuar dhe shqyrtuar dokumentacioni, si në vijim:

- *Dëshmia mbi pronësinë për parcelën kadastrale: kopjet e planit dhe Certifikata e njësisë kadastrale të parcelave kadastrale* nr.1871-0, 1840-5 dhe 1873-9 ZK Prishtinë, *lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës;*
- *Fotokopja e pa vërtetuar e Vendimit të lejes ndërtimore 05nr.351/02 – 55905/19 dt.16.07.2019, për ndërtimin e ndërtesave shumë banesore & afariste - Kompleksi "Ylli" – Objekti "A" – B+2S+P+7, Objekti "B" – B+2S+P, Objekti "C" – 2B+S+P+7 dhe Objekti "G" – 2B;*
- *Fotot e lokacionit;*
- *Manuali i ndarjes së parcelave kadastrale nr.1840-5 dhe 1873-9 ZK Prishtinë, punuar nga gjeometri i licencuar Ferid Nj. Ahmeti nga Prishtina me licencë nr.174;*
- *Certifikatën e regjistrimi të biznesit ARBK të "Bashkimi Projekt"sh.p.k. nga Prishtina , nr.810799504;*
- *Certifikatën e regjistrimi të biznesit "BP Construction"sh.p.k. nga Prishtina , nr.810052887;*
- *Vërtetimi i obliguesit tatimor të "BP Construction"sh.p.k. me nr.307407/19 dt.19.12.2019;*
- *Vërtetimi i obliguesit tatimor të Kujtim Vokrri me nr.309616/19 dt.23.12.2019;*
- *Vërtetimi i obliguesit tatimor të Bajram Elezkurtaj me nr.22678/20 dt.29.01.2020;*
- *Vërtetimi i obliguesit tatimor të Lulzim Dulatahi me nr.23504/20 dt.29.01.2020;*
- *Vërtetimi i obliguesit tatimor të Përparim Dulatahi me nr.23504/20 dt.29.01.2020;*
- *Vërtetimi i obliguesit tatimor të Blerta Dulatahu-Lleshi me nr.23504/20 dt.29.01.2020;*
- *Vërtetimi i obliguesit tatimor të Shaip Zeka me nr.307407/19 dt.19.12.2019;*
- *Vërtetimi i obliguesit tatimor të Naser Zeka me nr.22678/20 dt.29.01.2020;*
- *Vërtetimi i obliguesit tatimor të Kujtim Vokrri me nr.22678/20 dt.29.01.2020;*
- *Fotokopja e dokumenteve të identifikimit, të pronarëve dhe investitorit;*
- *Akti noterial "Kontratë për ndërtim dhe investim të përbashkët", e lidhur në mes të Lulzim Dulatahi, dhe "BP Construction"sh.p.k. nga Prishtina, përpiluar te Notere Arteida Asllani në Prishtinë, me LRP.nr.trend:98/2020 dhe LRP.nr.ref:19/2020 dt.27.01.2020;*
- *Akti noterial "Aneksi – I-rë i Kontratë për ndërtim dhe investim të përbashkët", e lidhur në mes të Naser Zeka dhe "BP Construction"sh.p.k. nga Prishtina, përpiluar te Notere Arteida Asllani në Prishtinë, me LRP.nr.trend:91/2020 dhe LRP.nr.ref:17/2020 dt.27.01.2020;*
- *Fotokopja e pa vërtetuar e "Kontratë për ndërtim dhe investim të përbashkët", e lidhur në mes të Bajram Elezkurtaj dhe "BP Construction"sh.p.k. nga Prishtina, përpiluar te Notere Arteida Asllani në Prishtinë, me LRP.nr.trend:847/2018 dhe LRP.nr.ref:183/2018 dt.28.09.2018;*
- *"Informim nga Plani Rregullues Kalabria-PZHU" nr.04nr.350/01 – 100635/18 dt.15.05.2018, lëshuar nga DPSZHQ e Komunës së Prishtinës;*
- *Fotokopjen e pa vërtetuar të Vendimit të kushteve ndërtimore 05nr.350/02 – 0259372/18 dt.11.12.2018, lëshuar nga kjo drejtori;*
- *Projekt propozimin – projektin ideor dhe ai kryesor me zgjidhjes urbane me të Kompleksit "Ylli", hartuar nga "Bashkimi Projekt" sh.p.k. nga Prishtina, me projektues Orhan Morina.*

Drejtoria e Urbanizmit, në fazën e shqyrtimit të kërkesës, 05 nr. 350 /03 - 23549/20 dt.29.01.2020 dhe dosjen e lëndës 05nr.350/02 – 0259372/18 dt.26.10.2018, dokumentacionin e prezantuar me kërkesë dhe atij të trajtuar gjatë fazës së procedimit administrativ, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për zonën / hapësirën e lokacionit, rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe projekt propozimit me Planin e situacionit - "zgjidhja urbane", në mënyrë kronologjike konstatoi se:

Drejtoria e Urbanizimit, bazuar në kërkesën 05nr.350/02 – 0259372/18 dt.26.10.2018, me aktin administrative Vendimin 05nr.350/02– 0259372/18 dt.11.12.2018, ka caktuar kushtet ndërtimore

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e ***Kompleksi "Ylli"*** me ndërtesë shumë banesore & afariste – Objekti "A", "B", "C" & "G", në kuadër të Bllokut urban "C-4", të Planit Rregullues "Kalabria" dhe PZHU-së në Prishtinë;
Gjithashtu, kjo drejtori bazuar në kërkesën 05nr.351/02 – 55905/19 dt.11.03.2019, për leje ndërtimi me Vendimin 05nr.351/02 – 55905/19 dt.16.07.2019, ka lejuar ndërtimin kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste – Kompleksi "Ylli" – Objekti "A" me B+2S+P+7 me S=6527.50m² /5091.70m², mbi tokë & 1435.80m², nën tokë/, Objekti "B" me B+2S+P, me S=919.60m² / 459.90m², mbi tokë & 459.80m², nënë tokë/, Objekti "C" me 2B+S+P+7 me S=5215.90m² / 3782.70m², mbi tokë & 1433.20m², nënë tokë/, dhe Objekti "G" me 2B+0, me S=1802.40m² / 0.00m², mbi tokë & 1802.40m², nënë tokë/, me sipërfaqe totale të ndërtesave S=14465.40 m²/ 9334.20m², mbi tokë + 5131.2 m², nën tokë/, në kuadër të parcelës kadastrale nr.1871-0 ZK Prishtinë;

Investitori "BP Construction"sh.p.k. nga Prishtina, rr."Uran Ajeti",BL.-C-16,H-1A,Lok.3-4, me certifikatë të regjistrimit të biznesit 810052887, pas fillimit të ndërtimit të kompleksit të lartë cekur, pas konsultimin të dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe rregullativës ligjore në fuqi, dhe konsultimit në mënyrë verbale në Drejtorin e Urbanizmit, përmes akteve noteriale ka arrite marrëveshje me pronarët e parcelave kadastrale nr.1840-5 dhe 1873-9 ZK Prishtinë, për transferimin e pjesëve të parcelave që shtrihen në hapësirë publike, në Kompleksi "Ylli", konkretisht mbindërtimin e Lam."A" me B+2S+P+7 në etazhitet B+2S+P+8;
Andaj përmes kërkesës 05 nr. 350 /03 - 23549/20 dt.29.01.2020, ka kërkuar nga kjo drejtori ndryshimin, plotësimin dhe zgjerimin e Vendimit të kushteve ndërtimore 05nr.350/02– 0259372/18 dt.11.12.2018 dhe pranimin e palëve në procedurë-përfshirje në 'zgjidhje urbane" dhe ndërtim, duke prezantuar edhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim;

Pas pranimit të kërkesës së lartë cekur dhe konsultimin e dokumentacionit u konstatua se pjesët e parcelave kadastrale nr.1840-5 dhe 1873-9 ZK Prishtinë, konkretisht nr.1840-5 me S=129m² dhe nr.1873-9 me S=209m², sipas incizimit gjeodezik të prezantuar dhe punuar nga gjeometri i licencuar Ferid Nj. Ahmeti nga Prishtina me licencë nr.174,ku paraprakisht, para pajisjes me leje ndërtimore është realizuar kompensimi / shpronësimi me koeficient ndërtimi i pjesës së parcelës kadastrale nr.1871-0 ZK Prishtinë në sipërfaqe prej S=1409m², andaj edhe për pjesët e parcelave kadastrale të lartë cekura ka hapësirë për trajtim sipas Vendimit 01nr.031 – 185483 dt.14.08.2015 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, gjegjësisht gjerë në maksimumin e përcaktuar me PZHU-në ;
Pasa analizës së pozitës së parcelave kadastrale në kuadër të planit rregullues dhe PZHU-së dhe Vendimin 01nr.031 – 185483 dt.14.08.2015 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, u konstatua se në fazën fillestare me Vendimin e kushteve ndërtimore 05nr.350/02– 0259372/18 dt.11.12.2018, për parcelën kadastrale nr.1871-0 ZK Prishtinë me S=5186m², duke llogaritur edhe shpronësimi / kompensimin me sipërfaqe ndërtimore janë lejuar S=9334.23m² të kalkuluar me koeficient ndërtimi 1.8. Andaj, nëse i referohemi parcelës ndërtimore me S=3777m², dhe pjesën e parcelës që shtrihet në hapësirë publike S=1409m², konstatohet se janë trajtuar gjithsej S=3777 + 1409=5186m², dhe sipas koeficientit maksimal të PZHU-së, mbetet hapësirë ende për trajtim. Pra, nëse i referohemi koeficientve të PZHU-së, 1.8 ÷ 3.0, konstatohet se parcela ndërtimore mund të ngarkohet-mund të pranoj max. S=3777 x 3.0=11331m², sipas të cilit kalkulim dhe raportit të sipërfaqes së lejuar për ndërtim, mund të konstatohet se në kuadër të parcelës kadastrale nr.1871-1 ZK Prishtinë (formuar pas ndarjes së parcelës nr.1871-0 ZK Prishtinë), me S=3777m² mund të transferohen edhe S=11331 – 9334.23=1996.77m².
Pasi pjesët e parcelat kadastrale nr.1840-5 dhe 1873-9 ZK Prishtinë, të propozuara për transferim janë me sipërfaqe të përgjithshme prej S=129 + 209=338m², të cilat kalkuluar me koeficient ndërtim japin sipërfaqen ndërtimore prej S=338 x 1.8=608.40m², e cila sipërfaqe së bashku me sipërfaqen e lejuar për ndërtim me Vendimin 05nr.351/02 – 55905/19 dt.16.07.2019, përbëjnë sipërfaqen prej S=9334.23 + 608.40=9942.63m², e cila sipërfaqe është brenda parametrave të PZHU-së, gjegjësisht më e vogël se maksimumi i lejuar prej S=11331m², për parcelën ndërtimore, andaj edhe mund të konstatohet se kërkesa si e tillë mund të pranohet dhe të bëhet ndryshimi, plotësim dhe zgjerimi kushteve ndërtimore.
Bazuar në pikën 5 të paragrafit II. të Vendimit 01nr.031–185483 dt.14.08.2015 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, në të cilin konstatohet se, citojmë *"Per tu realizuar e drejta nga paragrafet*

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

e me sipërme të ketij neni është e obligueshme që të arrihet nje marreveshje në mes te gjitha palëve të përfshira dhe përmes se ciles marrëveshje duhet të shprehet vullneti mbi pranimin e te drejtave dhe obligimeve që sjelle transferimi i te drejtave ndërtimore", konstatohet se e njejta është arritur përmes kontratave të lidhura në mes pronarve të tokave dhe investitorit, konkretisht pikes 6 të nenit 3 / *Afatet kohore* / në të cilin, pronarët e parcelave kadastrale kanë lënë në kompetencë të investitorit të gjitha çështjet procedurale, ndër të tjerashe edhe këtë marrveshje, andaj edhe mund të konstatohet se është plotësuar ky kusht;

Bazuar në konstatimet e më sipërme, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174dt. 31.07.2013, UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuesit kanë prezantuar të gjithë dokumentacioni e nevojshëm për miratimin e ndryshimit, plotësimit de zgjerimit të kushteve ndërtimore, se plani i situacionit - "zgjidhja urbane" e propozuar me projekt propozimin konceptual, është në harmoni me destinimin e planit rregullues urban dhe PZHU-së për atë hapësirë, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për miratimin e kërkesës ndryshimit, plotësimit de zgjerimit të kushteve ndërtimore;

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacionit -"zgjidha urbane" e Kompleksit "Yllit" me ndërtesë shumë banesore & afariste, të planifikuar, me hapësirat përcjellëse dhe Manuali i ndarjes së parcelës nr.1840-5 & 1873-9 ZK Prishtinë, punuar nga gjeodeti i licencuar Ferid Nj. Ahmeti nga Prishtina.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do ti përcillet organit epror – MMPH-së.

I dërgohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Drejtorisë së Pronës, në dosje të lëndës 05 nr. 350 /02 - 0259372/18 dt.26.10.2018, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

I dërgohet përmes postës elektronike: Drejtorisë për Pronën, Drejtorisë për Kadastër, Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/02 – 0259372/18 DT. 12.02.2020

Zyrtari:
Ergyn Hajredini

U.D. Udhëheqëse e Sektorit:
Mimoza Berisha Prestreshi

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGECIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice :01840-5

Zona kadastrale / Katastarska zona: Prishtinë

Numri i lëndës / Broj predmeta: /2019

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcelë

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1:500

Propozim për ndarje te parceles

Nr	Y	X
1	7512415.612	4722059.068
2	7512408.767	4722062.610
3	7512403.675	4722065.875
4	7512398.577	4722069.734
5	7512394.258	4722073.601



Rilevoi / Snimio: Ferid Nj.Ahmeti
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 174

Nënshkrimi / Potpis:

Data e rilevimit / Datum snimanja: 24.12.2019

LICENCUAR - LICENCIRANI GEODETA
V.V.
FERID NJ. AHMETI
GJE
Prishtinë

Aprovoi / Usvojio:
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nënshkrimi / Potpis:

Data e aprovimit / Datum usvajanja:

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGECIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice :01873-9

Zona kadastrale / Katastarska zona: Prishtinë

Numri i lëndës / Broj predmeta: /2019

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcelë

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 700

Propozim për ndarje te parceles

Nr	Y	X
1	7512257.570	4722267.911
2	7512288.519	4722261.412



Rilevoi / Snimio: Ferid Nj.Ahmeti
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 174

Nënshkrimi / Potpis:

Data e rilevimit / Datum snimanja: 10.04.2019

LICENCUAR - LICENCIRANI GEODETA
FERID NJ. AHMETI
Prishtinë

Aprovoi / Usvojio:
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nënshkrimi / Potpis:

Data e aprovimit / Datum usvajanja:



OBJEKTI C 2B+S+P+8		
Sipërfaqet ndërtimore nën tokë		
Etazha	Siperfaqja/m²	
Bodrumi -2	621.40	m²
Bodrumi -1	541.20	m²
Sutereni (50%)	270.60	m²
Siperfaqja nën tokë	**1433.20**	**m²**
Sipërfaqet ndërtimore mbi tokë		
Sutereni (50%)	270.60	m²
Perdhesa	466.30	m²
Kati I-rë	458.10	m²
Kati II-të	462.30	m²
Kati III-të	462.30	m²
Kati IV-të	462.30	m²
Kati V-të	462.30	m²
Kati VI -të	462.30	m²
Kati VII-të	462.30	m²
Kati VIII-të	422.00	m²
Siperfaqja mbi tokë	**4390.80**	**m²**
Siperfaqja ndërtimore	**5824.00**	**m²**

Investitor:

"BP CONSTRUCTION", SH.P.K.

Studio projektuese:

BASHKIMI PROJEKT

bashkimiprojekt@gmail.com

+377 45 540 943; +377 45 567 100;

Emri i projektit:

Projekti Ideor i Objektit

Banesor-Afarist

Objekti C - 2B+S+P+8

Blloku C 4 - Lagjja" Kalabria ", Prishtinë

projektuesi: *i.d.a. Orhan MORINA*

Faza e Projektit:

Arkitektura

Emri i Vizatimit:

Situacioni i ngushtë

Vula:

BASHKIMI PROJEKT SHPK PRISHTINË

Përpjesa: P=1:200, 1:1.19

Data: Dhjetor 2019

Formati i fletës: A2

Nr. i fletës: